

Ndërmjetësimi shëndetësor i Kryqit të Kuq

Tek ne, infermierët punojnë për të ofruar ndihmë dhe mbështetje për personat që jetojnë pa dokumente dhe për migrantët e tjerë që janë jashtë sistemit të mbrojtjes shoqërore.

Ne ndihmojmë me

- Udhëzime dhe kontakt me sistemin e zakonshëm të kujdesit shëndetësor, që ti si person pa dokumente të marrësh kujdesin që të takon.
- Mbështetje për ty që jeton pa dokumente dhe që has pengesa në kontaktin me kujdesin shëndetësor.
- Mbështetje për ty që je ofrues i kujdesit shëndetësor dhe që ke kontakt me grupet e pacientëve të përmendura më sipër. Ndërmjetësim për aktivitete informuese në vendin e punës.
- Kontakt me një punonjës social për ty që jeton pa dokumente dhe ke pyetje lidhur me mbështetjen sociale.

Pranimi

Mund të vish pa caktuar kohë të martën – të enjten nga ora 09:00 – 12:00 dhe 13:00 – 16:00.

Adresa: Rullagergatan 6B, Gamlesta-den, Göteborg. Mund të rezervosh edhe takim paraprakisht.

Këshillimi kombëtar

Orari i telefonit: e hënë – e premte nga ora 09:00 – 12:00

Numri i telefonit: 020-211 000
Mund të dërgosh edhe SMS në:
072-349 98 08

Adresa e emailit:
papperslos@redcross.se

Vizita dhe telefonatat janë pa pagesë. Ne kemi detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit.

Më shumë informacion

Përmes bashkëpunimit me organizata të tjera të shoqërisë civile, ekziston mundësia për të takuar infermierët tanë në disa vende të rajonit Västra Götaland. Skanoni kodin QR për të parë se ku ndodhemi në rajon.



Lexoni më shumë rreth kujdesit shëndetësor për personat pa dokumente dhe migrantët e tjerë. Në faqe ka gjithashtu informacion për të drejtën tuaj për kujdes shëndetësor në disa gjuhë të ndryshme.



Informacion për personelin shëndetësor. Mund t'ua tregoni këtë kur kërkon ndihmë mjekësore.



Svenska Röda Korset

Form: Head & Head. Illustrationer: Sabina Helmola. 260701. Redigerad 25/11/11 Lou Dahlgren Ellegren

Për ty që jeton pa dokumente

dhe gjendesh në rajonin Västra Götaland



Informacion për mjekim për grupe tjera emigrantësh

Informacion nga Vårdförmedling Västra Götaland,
një bashkëpunim në mes të Fondacionit Rosengrenska, Kryqit të Kuq dhe raajonit Västra Götaland



Medfinansieras av
Europeiska unionen

Version 2025-06-25



VÄSTRA
GÖTALANDSREGIONEN



Svenska Röda Korset

Rajoni Västra Götaland

Të gjithë fëmijët pa dokumente kanë të drejtë për të njëjtin kujdes shëndetësor si fëmijët e rezident.

Ti që je mbi 18 vjeç dhe jeton në Suedi pa leje ke të drejtë për kujdes shëndetësor dhe mjekim që nuk mund të shtyhet. Kjo do të thotë se ke të drejtë për

- Mjekim urgjent (mjekim i menjëhershëm)
- Mjekim para lindjes dhe gjatë lindjes
- Këshilla për kontraceptivë (si të mbrohesh nga shtatzënia)
- Mjekim në rast aborti (për të ndërprerë një shtatzëni)
- Mjekim dhe trajtim të sëmundjeve dhe dëmtimeve ku edhe një vonesë e moderuar mund të ketë pasoja serioze për ty
- Mjekim që mund të parandalojë përkeqësimin e gjendjes sate
- Mjekim që mund të parandalojë trajtime dhe mjekim më të gjerë
- Mjekim që është vazhdim i trajtimit që ke marrë më parë, përfshirë edhe mjekimin psikiatrik

Ke gjithashtu të drejtë për:

- Një kontroll shëndetësor në qendrën shëndetësore
- Udhëtime për shërbime shëndetësore
- Ilaçe që përfshihen në listën e rimbursimit
- Pajisje ndihmëse

Ky është mjekim që duhet të ofrohet për ty brenda shëndetësisë rajonale. Pra, në qendrën tënde shëndetësore, qendrën e kujdesit për shtatzënat, urgjencë ose në spital.

Fëmijët pa dokumente kanë të drejtë për të njëjtin mjekim dentar si fëmijët e rezident. Të rriturit mbi 18 vjeç kanë të drejtë për mjekim dentar të menjëhershëm dhe mjekim dentar që nuk mund të shtyhet. Deri në vitin që mbush 20 vjeç, mjekimi dentar është falas.

Nga viti që mbush 20, paguan 50 korona për vizitë.

Nuk duhet të të mohohet kurrë mjekimi pa

u takuar më parë me një infermier/e ose mjek që ka bërë një vlerësim të nevojës sate për mjekim. Kjo do të thotë se nuk duhet të të mohohet kurrë mjekimi në një recepsion. Nuk ke kurrë nevojë të dëshmosh që je pa dokumente.

Nëse dëshiron të kontaktosh njërën nga njësitë tona për refugjatë, për shembull për të marrë informacion rreth kontrolleve shëndetësore, mund t'i kontaktosh në:

Qendra mjekësore për refugjatë

Orari i telefonit: 09.00–15.00

Telefoni 031-747 89 50

Qendra për fëmijët refugjatë

Orari i telefonit: 08.00–10.00

Telefoni 070-020 60 26

Qendra për fëmijët refugjatë pranon fëmijë dhe të rinj me probleme fizike ose psiqike pas emigrimi ose ikjes si refugjat. Atje mund të takosh pediatër, psikiatër për fëmijë, psikologë dhe infermiere specialistë.

Ata takojnë fëmijët, prindërit dhe ndonjëherë tërë familjen.

Për t'u pranuar në këtë qendër, qendra jote shëndetësore duhet të shkruajë një udhëzim për ta.

Gjithashtu mund të shkruash vetë udhëzimin.

Më shumë informacion

Shërbimi këshillues shëndetësor 1177
Informacione rreth mjekimit për ty që jeton pa dokumente ose je azilkërkues



VÄSTRA
GÖTALANDSREGIONEN

Rosengrenska

Rosengrenska i drejtohet ty që je pa dokumente. Ne kemi pranim një mbrëmje çdo dy javë.

Në Rosengrenska mund të marrësh ndihmë nga:

Infermier/e, dentist ose psikolog

Mund të takosh një infermier/e, dentist ose psikolog në pritjen e Rosengrenska-s nëse ke nevojë për mjekim por nuk di ku të shkosh, nuk e di si funksionon sistemi shëndetësor në Suedi, nëse je trajtuar keq në shëndetësi, të është mohuar mjekimi ose ke marrë një faturë të gabuar nga shëndetësia.

Nëse ke nevojë për mjekim ose mjekim dentar, do të marrësh informacion se si të kontaktosh ofruesin tënd shëndetësor dhe si të gesh rrugën e duhur në shëndetësi.

Arka

Këtu mund të marrësh para mbrapsht për vizitat në shëndetësi dhe ilaçet e blera me recetë. Duhet të kesh me vete faturat (kviton).

Optiku

Optiku është i pranishëm në Rosengrenska një herë në muaj. Ai ndihmon me kontrollin e shikimit dhe të jep syze falas nëse i ke të nevojshme.

Mbështetje sociale

Ne bashkëpunojmë me një kishë në Göteborg. Pavarësisht se cilës fe apo bindje i përket, diakonët e kishës ofrojnë biseda, mbështetje dhe këshillim. Mund të bëhet fjalë për çështje rreth fëmijëve dhe familjes, shkollimin e fëmijëve, ndihmë me ushqime dhe rroba ose orientim shoqëror. Ekziston gjithashtu mundësia për biseda dhe mbështetje me një prift ose kontakt me Këshillin Ndërfetar në Göteborg.

Juristi

Ne bashkëpunojmë me juristë që ofrojnë këshillim juridik falas. Mënyra më e mirë për t'i kontaktuar është duke rezervuar një takim përmes emailit: info@rosenjuristerna.se, përmes faqes së tyre rosenjuristerna.se, ose përmes një liste në ordinancën e Rosengrenska-s. Ata pastaj do të të kontaktojnë dhe do të të japin një kohë për takim.

Si të kontaktosh me ne

Që vizitorët tanë të ndihen të sigurt, ne nuk shkruajmë kohën dhe vendin e ordinancës.

Nëse ke nevojë të dish se ku ndodhemi, kontaktoje Kryqin e Kuq ndërmjetësimin shëndetësor në 020-211 000.

Më shumë informacion

Lexo më shumë për fondacionin Rosengrenska

